



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Data: 14.11.2023

Nr: 819

Ora: 12:00

VENDIM

PËR

**PLOTËSIMIN E VAKANCËS NË KËSHILLIN E BASHKISË TIRANË, ME KANDIDATIN NGA LISTA SHUMEMËRORE TË "PARTISË SOCIALISTE TË SHQIPËRISË", ZJ. XHENI NAMIK HATILLARI**

Në mbështetje të neneve 19, pikat 1, shkronja "n" e 2 dhe 164, pikat 2 dhe 4, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, nenit 11, të ligjit nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", Kreut V, të vendimit nr. 17/2016, të Kuvendit, "Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", pasi shqyrtova dokumentacionin përkatës,

VËREJ:

Me shkresën nr. 33743 prot., datë 2.10.2023, Këshilli i Bashkisë Tiranë, ka njoftuar Komisionin Qendror të Zgjedhjeve për krijimin e vakancës nga këshilltari, zj. Katerina Nikolin Marku, propozuar nga subjekti politik "Partia Socialiste e Shqipërisë".

Referuar nenit 164, pika 2, të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar, kandidati vijues nga lista shumemërore të "Partisë Socialiste të Shqipërisë", për Këshillin e Bashkisë Tiranë, të cilit i kalon mandati i këshilltarit, është kandidati me numër rendor 37, zj. Xheni Namik Hatillari.

Me shkresën nr. 7134, prot., datë 6.10.2023, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve i është drejtuar kandidatit për anëtar në Këshillin e Bashkisë Tiranë, zj. Xheni Namik Hatillari, me kërkesë për plotësim dokumentacioni.

Data: 14.11.2023 Nr: 819  
Ora: 12:00



"Për plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Tiranë me kandidatin nga lista shumemërore të "Partisë Socialiste të Shqipërisë", zj. Xheni Namik Hatillari".

Në bazë të nenit 11, të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, vetëdeklarimi dhe verifikimi i kushteve të të dhënave në përputhje me këtë ligj, kryhet për çdo kandidat të listës shumemërore për zgjedhjet pararendëse, për këshillin bashkiak, të cilit i takon të marrë mandatin e këshilltarit për vendin vakant.

Kandidati për këshilltar, përcaktuar në bazë të listës shumemërore, të subjektit “Partia Socialiste e Shqipërisë”, ka plotësuar e depozituar formularin e vetëdeklarimit, me numër 36 unik, në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, si organi kompetent për administrimin, verifikimin, zbatimin e ndalimeve për zgjedhjen dhe emërimin në funksionin publik, ku përfshihet dhe funksioni i këshilltarit të bashkisë.

Nga verifikimi i formularit të vetëdeklarimit të zj. Xheni Namik Hatillari, rezulton se nuk ka deklaruar asnjë të dhënë që ka të bëjë me parashikimet për ndalime në ligjin nr. 138/2015.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në zbatim të ligjit nr. 138/2015 dhe Kreut V, pika 2, shkronja “b” dhe pika 3, shkronja “c”, të vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit, me shkresën nr. 7247 prot., datë 19.10.2023, ka kërkuar informacion nga Zyra e Gjendjes Civile dhe me shkresën nr. 7248 prot., datë 19.10.2023, ka kërkuar informacion nga Zyra e Gjendjes Gjyqësore për zj. Xheni Namik Hatillari.

Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, me shkresën nr. 11160/1 prot., datë 27.10.2023, ka dërguar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, verifikimin e të dhënave për kandidatin për anëtar zj. Xheni Namik Hatillari, ku konstatohet se kandidati nuk ka ndryshime në përbërësit e gjendjes civile.

Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Gjyqësore, me shkresën nr. 13558/1 prot., datë 24.10.2023, ka dërguar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, verifikimin e gjendjes gjyqësore për zj. Xheni Namik Hatillari, ku konstatohet se kandidati nuk është i dënuar me vendim penal të formës së prerë.

Në mbështetje të pikës 2, të Kreut V, të vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit konstatohet se të dhënat e kandidatit për anëtar zj. Xheni Namik Hatillari në Këshillin e Bashkisë Tiranë, nuk përbëjnë kusht për moszgjedhjen e kandidatit në funksionin e këshilltarit.

### **PËR KËTO ARSYE:**

Bazuar në nenet 19, pikat 1, shkronja “n” e 2 dhe 164, pikat 2 dhe 4, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, nenin 11, të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, Kreun V, të vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit, “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”

## V E N D O S:

1. Plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Tiranë, me kandidatin nga lista shumemërore të “Partisë Socialiste të Shqipërisë”, zj. Xheni Namik Hatillari.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga shpallja e tij.

**Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**

**Ilirjan CELIBASHI**